



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5287 Prot.
11

Pogradec më 19 /11/2021

VENDIM

Nr: 100, datë 19 /11/2021

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE DHE PLANIT TË
KONSULTIMEVE PUBLIKE TË KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN
2022**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, pika a dhe neneve 28 pika 3, 56, pika 1, gërma g, 134, pika 2 dhe 152, pika 2 e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Pogradec me propozim të Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Aktiviteteve dhe Planin e Konsultimeve Publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2022 bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Këshillit dhe Sekretariati i Këshillit.
3. Plani i aktiviteteve i nënshtrohet ndryshimeve të herëpashërëshme dhe përditësohet nga Sekretariati i Këshillit pa apasur nevojë për miratim.
4. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotirajq MANGËRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI I BASHKISË

DOKUMENTI I DEKLARIMIT TË POLITIKAVE ORJENTUESE TË KËSHILLIT TË
BASHKISË POGRADEC PËR PERIUdhËN VITIN 2022

Ky dokument përcakton prioritetet kryesore të politikave të punës së Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2022. Me anën e këtij dokumenti anëtarët e Këshillit të Bashkisë bien dakort të punojnë së bashku për të realizuar objektivat e përcaktuara më poshtë duke orjentuar punën e tyre në aktivitetet në funksion të këtyre politikave dhe duke i detajuar ato në plan aktivitetesh.

Ky dokument bazohet në të drejtat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Bashkisë të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Me synimin për të planifikuar ushtrimin sa më mirë të këtyre koepetencave dhe me qëllimin e përfaqësimit të interesave të komunitetit dhe grupeve të interesit që përfaqësojnë anëtarët e këtij Këshilli:

VENDOSËM

- Të punojmë së bashku për fuqizimin e rolit të Këshillit të Bashkisë në vendimarrje përfaqësimit dhe monitorim/mbikqyrje duke bashkëqeverisur së bashku me komunitetin.
- Të realizojmë qeverisje së bashku me komunitetin duke ushtruar së bashku më qytetarët rolin vendimmarrës, përfaqësues dhe monitorues. Për këtë qëllim:
 - o Të sigurojmë transparencë për vendimarrjen duke përfshirë sa më shumë pjesëtarë të komunitetit në këtë proces.
 - o Të japim mundësinë cdo anëtarit të komunitetit tonë që të ketë informacion mbi projekt aktet dhe aktet të cilat miratohen si dhe të ketë mundësinë të shprehë lirshëm mendimin dhe opinionin e tij për cdo çështje që shtrohet për miratim.
 - o Të krijojmë mundësi ndërveprimi më anëtarët e komunitetit për të përcjellë cdo shqetësim apo ankesë, për të ndërmarrë cdo iniciativë vendimarrëse për shërbimet publike që ofron bashkia.



- o Të informohemi nga administrata dhe të informojmë komunitetin tonë mbi cdo investim, apo plan strategjik zhvillimor duke kërkuar mendime dhe sygjerime nga komuniteti.
- o Të informojë qytetarët jo vetëm mbi çështjet e detyrueshme për konsultim të cituara shprehimisht nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" por edhe duke bërë transparencë për të ardhurat, shpenzimet dhe mënyrën e kryerjes së shërbimeve publike nga ana e Bashkisë.
- o Për të qënë sa më afër komunitetit dhe për të bashkëqeverisur me ta, do përdorim mekanizmat e bashkëqeverisjes, transparencës në cdo akt që do ndërmarrim, duke riorganizuar, përmirësuar edhe krijuar mekanizmat e mëposhtme:
 - Përmirësuar ndërfaqen e Këshillit të Bashkisë Pogradec.
 - Publikimin e cdo projekt akti ose nevoje për vendimarrje si dhe duke nxitur reagimin qytetar me praktikat më të mira.
 - Konsideruar, shqyrtuar dhe zgjidhur me seriozitet cdo ankesë, kërkesë, nismë apo peticion qytetar e cila është brenda fushës së veprimit të pushtetit vendor.
- Për këtë qëllim angazhohemi të rritim aftësitë profesionale duke marrë pjesë në trajnime dhe zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe rritur besimin e qytetarëve në institucionin tonë.
- Për këtë qëllim, pas diskutimit në grupet e punës dhe të interesit biem dakort të orientojmë punën tonë sipas planit të aktiviteteve bashkangjitur këtij dokumenti.
- Janë të mirëpritura iniciativat dhe sygjerimet nga të gjithë banorët për të bërë pjesë të këtij plani aktivitesh cdo çështje tjetër e cila vlerësohet e rëndësishme.

Ju Faleminderit!

- ***Ky dokument është i shoqëruar nga Plan i Aktiviteteve, Plan i Konsultimeve Publike bashkangjitur.***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI I BASHKISË

PLAN I KONSULTIMEVE PUBLIKE TE KESHILLIT BASHKIAK

(Viti 2022)

Plani I konsultimeve eshte vlerësim paraprak I nevojave për konsultim public. Ky plan do rishikohet dhe do përditësohet nga nevojat për konsultim që do vijnë nga project vendimet të cilat do paraqiten për vendimarrje duke parë detyrimin ligjor për konsultim dhe nevojën e këshillit për të realizuar procesin e konsultimit public.

Muaji Janar

1. Realizimi I konsultimi per grate sipërmarrëse për nevojat, eksperiencat dhe nevojat që kanë për vendimarrje nga Këshilli Bashkiak.

Muaji Shkurt

Muaji Mars

Muaji Prill

1. Konsultime fizike me bizneset për masat e nevojshme për vendimarrje për përgatitjen e sezonit veror. Kalendar I detajuar me 3 grupe biznesesh
2. Anketë on-line për marrje mendimi për masat e propozuara.

Muaji Maj

1. Konsultime publike fizike për prioritete për investime për vitin 2023 ne cdo njësi administrative. Drafti I parë I project buxhetit.
2. Anketim mbi planin e performances së vitit pararadhës.

Muaji Qershor

Muaji Korrik

Muaji Gusht



1. Konsultim me Emigrantët për buxhetin e vitit 2023.

Muaji Shtator.

1. Konsultime për draftin e dytë të project buxhetit 2023. Konsultime fizike dhe vazhdimi I anketimit të hapur në muajin qershor. (Detajimi I investimeve konkrete të cilat do investohen në vitin 2023).
2. Konsultim mbi barazinë gjinore mbi rezolutën që inicicion komisioni I barazisë gjinore.

Muaji Tetor

1. Realizimi i anketës mbi performancën dhe punën e Këshillit të Bashkisë për vitin 2022.

Muaji Nëntor

1. Realizimi I një ankete mbi gjendjen dhe standartet e shërbime publike.
2. Informim I këshillit nga Këshilli I sigurisë.

Muaji Dhjetor

1. Realizimi I një konsultimi mbi vlerësimin e figurave të bashkisë. Procedurat, kriteret.
 - *Ky plan i konsultimeve mund të ndryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.*
 - *Cdo ndryshim im tij nëpërmjet vendmarrjes, apo zhvillimit të konsultimit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan.*
 - *Takimet dhe konsultimet me komunitetin mund të realizohen edhe nëpërmjet rrjeteve sociale duke lënë gjithnjë të hapur mundësinë e dhënies së mendimeve dhe vërejtjeve nga të interesuarit. Cdo sygjërim, koment, apo mendim protokollohet nga Sekretari i këshillit dhe prezantohet në Komisionin përkatës apo mbledhjen e Këshillit.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI I BASHKISË

PLAN I AKTIVITETEVE TE KESHILLIT BASHKIAK

(Viti 2022)

Hartimit i planit të aktiviteteve synon përcaktimin e një kornizë orjentuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Pogradec duke pasur parasysh fuqizimin, ruajtjen e autonomisë së këshillit, si edhe siguron ushtrimin e funksionit legjislativ si organ përfaqësues, vendimarrës, mbikëqyrës e monitorues. Ky plan aktivitetesh është orjentues dhe mundet të ndryshojë për çdo emergjencë, apo situatë të paparishikueshme në momentin e hartimit të tij.

Muaji Janar

3. 1 mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimmarrje

(Administrata, Kryetari; Sek Keshillit),

4. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjes së këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve),

5. Hartimi i auditimit të performances dhe buxhetimit për vitin paraardhës.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit, Auditimi në Bashki)

6. Realizimi i nje emisioni në mediat lokale për raportin e performancës së Këshillit.

(Kryetari i Këshillit)

7. Hartim i Planit vjetor të vendimmarrjes së Këshillit (ligji 146/2014, neni 16/b), Hartim i Planit vjetor të komunikimit dhe konsultimit me publikun, Hartimi i Planit dyvjeçar të trajnimit të keshilltareve; Hartim i Dokumentit të politikës për shpenzimet e Këshillit.

(Kryetari i këshillit, Sekretariati i këshillit)

8. Realizimi i permblidhesit të akteve të miratuara nga Keshilli dhe publikimi i tyre.



(Sekretariati I Këshillit)

9. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

*(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec
në Këshillin e Qarkut Korçë)*

10. Këshilli merr nga Kryetari i Bashkisë për shqyrtimit raportin për parashikimin afatmesme të të ardhurave, për një periudhë 5 vjeçare (Ligji nr. 68/2017, neni 34/1; Udhëzimi i MinFin nr. 22 datë 30.7.2018 'Për monitorimi i buxhetit njësisve qeverisjes vendore')

(Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore)

Muaji Shkurt

11. 1 mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimmarrje

(Administrata, Kryetari; Sek Keshillit),

12. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjes së këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit , anëtarët e Komisioneve),

13. Hartimi i raportit vjetor të zbatueshmërisë së akteve nga administrata e Bashkisë.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

14. Realizimi I trajnimeve me keshilltare me tematike sipas kerkesave te donatoreve dhe trajnuesve.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit, anetare te Komisioneve sipas tematikes)

15. Përfundimi I vendimarrjes për Hartimin e Planit vjetor të vendimarrjes së Këshillit (ligji 146/2014, neni 16/b), Hartim i Planit vjetor të komunikimit dhe konsultimit me publikun, Hartimi I Planit dyvjeçar te trajnimit te keshilltareve; Hartim i Dokumentit të politikës për shpenzimet e Këshillit.

(Kryetari i këshillit, Sekretariati i këshillit)

16. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

*(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec
në Këshillin e Qarkut Korçë)*



17. Informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në lidhje me zbatimin e Vendimit "Mbi miratimin e numrit të pergjithshëm të punonjesve të Bashkisë Pogradec dhe ndermarrjeve të varesise si dhe nivelit të pagave për vitin 2020", vendimarrjet e vitit 2020; njohja e Këshillit me urdhërat dhe vendimet në lidhje me punësimët, trajnimet e punonjesve, pozicionet të cilat ende kanë mbetur vakante, afatet për zhvillimin e konkurseve si dhe planifikimin e punës së kësaj drejtorie për periudhën 2021.

(Drejtoria e Burimeve njerëzore)

18. Këshillit informohet dhe diskuton raportin e katër mujorit të tretë, dhe njëkohësisht i dymbëdhjetë mujorit, mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit paraardhës të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e paarkëtuara (*Udhëzimi i MinFin nr. 22 datë 30.7.2018 'Për monitorimi i buxhetit njësite qeverisjes vendore'*)

(Drejtoria e Financës dhe Taksave dhe tarifave vendore)

19. Trajnime për buxhetimin me bazë gjinore.

(Aleanca e grave Këshilltare)

Muaji Mars

20. 2 mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimarrje dhe vendimarrjen për raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave si dhe miraton tavanet e përgatitore për secilin program buxhetor.

(Administrata, Kryetari; Sek Këshillit Drejtoria e Finances dhe taksave vendore),

21. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

22. Hartimi i raportit vjetor statistikor për aktivitetet e realizuara nga këshilli i Bashkisë për vitin 2021.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit, anetare të Komisioneve sipas tematikës)

23. Raporti i Transparencës dhe vendimarrje së këshillit për vitin 2021.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit, anetare të Komisioneve sipas tematikës)

24. Organizimi i ceremonisë për dhënie tuitujsh nderi për vendimet e mara kryesisht mesues të dalluar.

(Kryetari i këshillit, Sekretari i këshillit)

25. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec)

26. Këshilli miraton tavaneve përgatitore për secilin program buxhetor Këshillit merr nga Ministria e Financave raport me komente dhe rekomandime mbi raportin e tretë katërmujor, dhe njëkohësisht i dymbëdhjetë mujorit, të monitorimit të buxhetit të Bashkisë, si dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës në rastet e konstatimit të vështirësive financiare. Këshilli miraton raportin për parashikimin e të ardhurave afatmesme të të ardhurave, për një periudhë 5 vjecare (*Ligji nr. 68/2017, neni 34/1*). Këshillit informohet dhe diskuton planin vjetor të prokurimit për të gjitha projektet e reja dhe ato në vazhdim të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

(Drejtoria e Financës, Taksave vendore, Prokurimet publike)

27. Raportim në Këshillin e Bashkisë të Ndërmarrjes së Ujësjetës Kanalizime sh.a. mbi situatën financiare, investimet dhe mbulimin e shërbimit në kuadër të sezonit të ri veror.

(Ujësjetës Kanalizime sh.a.)

28. Takim i Konferencës së Kryetarëve.

(Kryesia e Këshillit)

29. Informim i këshillit nga Këshilli i sigurisë.

(Këshilli i sigurisë)

Muaji Prill

30. 2 mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimmarrje dhe vendimarrjet eventalisht të pasuksesshme nga muaji mars.

(Administrata, Kryetari; Sek Këshillit Drejtoria e Financës dhe taksave vendore).

31. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

32. Realizimi i një fushate nxitese dhe informuese për qytetaret për të përdorur regjistrin elektronik të project akteve.

(Kryetari i këshillit, Sekretariati i këshillit)

33. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

34. Raportim në Këshillin e Bashkisë të Ndërmarrjes së Infrastrukturës mbi investimet dhe mbulimin e punimet dhe Planifikimi urban mbi masat e mara në kuadër të sezonit të ri veror.



(Infrastruktura, Planifikimi Urban)

Muaji Maj

35. I mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimmarrje.

(Administrata, Kryetari; Sek Keshillit Drejtoria e Finances dhe taksave vendore),

36. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit , anëtarët e Komisioneve).

37. Pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca sipas tematikave të insitucioneve dhe donatorëve.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit, anetare te Komisioneve sipas tematikes)

38. Pjesëmarrje e këshilltarëve në trajnime study-tours për të përmirësuar punën në lidhje me konsultimet publike, realizimin e planit të aktiviteteve etj.. Kjo mund te realizohet edhe nëpërmjet nje vizite studimore në një bashki mnë një tematikë të caktuar.

(Kryetari I këshillit, Sekretariati I këshillit)

39. Pjesëmarrje në aktivitetet për celjen e sezonit turistik 2021. Në aktivitet do ketë të ftuar edhe nga Këshilla Bashkiakë homologë.

(Kryetari I Këshillit dhe Sekretariati)

40. Realizimi I nje emisioni televiziv për pritshmëritë e sezonit veror.

(Kryetari I Këshillit)

41. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

42. Raportim në Këshillin e Bashkisë Sektorit të kulturës dhe sportit mbi përgatitjet për sezonin veror.

(Kultura dhe Sporti.)

43. Këshillit:

- a. informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për muajin Prill, mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë *(Ligji nr. 68/2017, neni 44/4)*.
- b. *Gjithashtu* Këshillit informohet dhe diskuton raportin e parë katër-mujor mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit korent të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e



paarkëtuara (Udhëzimi i MinFin nr. 22 datë 30.7.2018 'Për monitorimi i buxhetit njësisive qeverisjes vendore').

- c. Këshillit merr nga Kryetari i Bashkisë raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit vjetor të vitit paraardhës të Bashkisë (Ligji nr. 68/2017, neni 51/1).
- d. Këshilli njihet nga Kryetari i Bashkisë me projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm, të cilin Kryetari i Bashkisë ia dërgon brenda datës 1 qershor Ministrisë së Financave për mendime .

(Drejtorja e Financave)

Muaji Qershor

44. I mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimmarrje.

(Administrata, Kryetari; Sek Keshillit Drejtorja e Finances dhe taksave vendore),

45. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit , anëtarët e Komisioneve).

46. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

47. Raportim në Këshillin e Bashkisë Sektorit shërbimeve publike mbi gjendjen e shërbimeve, pastrim, gjelberim etj dhe vecanërsisht në kuadër të sezonit veror.

(Shërbimet publike)

48. Këshillit I paraqitet dhe me pas miraton **projektin e parë** të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, duke marrë parasysh edhe mendimet e Ministrisë së Financave.

(Financat)

49. Këshillit:

- a. Këshillit informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për muajin Maj, mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Ligji nr. 68/2017, neni 44/4).
- b. Këshillit merr nga Ministria e Financave raport me komente dhe rekomandime mbi raportin e parë katër-mujor të monitorimit të buxhetit të Bashkisë, si dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës në rastet e konstatimit të vështirësive financiare
- c. Këshilli shqyrton dhe miraton raportin e konsoliduar vjetor për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë (Ligji nr. 68/2017, neni 51/1)

(Drejtorja e Financave)

50. Komisioni I të gjithëve.



(Kryesia e Këshillit)

Muaji Korrik

51. 2 mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimmarrje si dhe realizimin e një mbledhje të dedikuar miratimit nga Këshilli i tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.

(Administrata, Kryetari; Sek Këshillit).

52. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

53. Pjesëmarrje në konferenca dhe trajnime sipas programeve tematikë të institucioneve qëndrore dhe donatorëve.

(Kryetari i Këshillit, Komisioni i ekonomisë, Sekretari i këshillit)

54. Hartimi i planit vjetor aktiviteteve, buxhetit dhe dokumentit të politikave për vitin pasardhës.
(Kryetari i këshillit dhe Sekretariati)

55. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

56. Këshillit informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për muajin Qershor, mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Ligji nr. 68/2017, neni 44/4).

(Financa)

57. Informacion nga Drejtoria e Shërbimit pyjor. Gjëndja e pyjeve, masat ndaj zjarreve në pyje, masat e mara administrative dhe koordinimi me institucionet për parandalimin e prerjes së pyjeve.

(Drejtoria e shërbimit pyjor)

Muaji Gusht

58. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimmarrje.

(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

59. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

60. Realizimi i një ankete mbi vlerësimin e gjëndjes së shkollave dhe nevojat për ndërhyrje.
(Sekretariati i Këshillit dhe Sektori i Arsimit në Bashki)



61. Pjesëmarrje në ceremonitë me rastin e çlirimit të Pogradecit, ku mund të organizohen edhe ceremony per dhenie titujsh nderi për figura patriotike.

(Kryetari i Këshillit, Këshilltarë)

62. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

63. Raportimi për masat e marra në insitucionet e arsimit parauniversitar, kopshte dhe çerdhe para fillimit të vitit mësimor dhe mbi gjendjen e strehimit.

(Sektori i Arsimit dhe sherbimeve ne arsim dhe sektori I strehimit)

64. Këshillit informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për muajin Korrik, mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Ligji nr. 68/2017, neni 44/4).

(Financa)

Muaji Shtator.

65. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.

(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

66. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

67. Pjesëmarrje në takimet e organizuara nga shoqatat e bashkive dhe për autonomi vendore ose shkëmbim experience në bashki ku janë zbatuar Projekte pilot për Këshillat Bashkikë.

(Kryetari i Këshillit dhe anëtarë të Këshillit).

68. Trajnime nga donator ose shkëmbime experience ku janë zbatuar Projekte pilot për Këshillat Bashkiakë.

(Sekretari i Këshillit)

69. Realizimi i një emisioni në Median locale ku të promovohet roli dhe puna e Këshillit të Bashkisë si dhe të realizohen pyetje përgjigje në lidhje me çështje të Këshillit të Bashkisë.

(Kryetari i këshillit, Kryetarët e 2 komisioneve dhe Sekretari i Këshillit)

70. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

71. Raportimi i performancës dhe ecurisë të Drejtorisë së emergjenës dhe bashkëpronësisë. Evidenca dhe objektiva.

(Drejtoria e Emergjencave civile dhe bashkepronësisë)



72. Këshilli:
- informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për muajin Gusht, mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Ligji nr. 68/2017, neni 44/4).
 - Këshillit informohet dhe diskuton raportin e dytë katër-mujor, dhe njëkohësisht tetëmuajor, mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit korent të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e paarkëtuara (Udhëzimi i MinFin nr. 22 datë 30.7.2018 'Për monitorimi i buxhetit njësisve qeverisjes vendore')
(Financa)

Muaji Tetor

73. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)
74. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).
75. Trajnim i Këshilltarëve për rolin monitorues të Këshillit të Bashkisë si dhe për praktikën e buxhetimit me pjesëmarrje, në një Bashki të pilotuar dhe sygjëruar nga Projektet dhe donatorët.
(Anëtarët e Këshillit)
76. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)
77. Raportim mbi ecurinë e investimeve të vitit 2021 dhe sektori I projekteve me donatorë
(Sekretari i Këshillit dhe Sektori i prokurimeve, Punët publike, sektori I projekteve me donator etj)
78. Konferenca e Kryetarëve.
(Kryesia e Këshillit)
79. Takim me shoqatat patriotike që veprojnë në Bashkinë Pogradec.
(Kryesia e Këshillit)

Muaji Nëntor

80. Realizimi i 2 mbledhjeve të Këshillit sipas nevojave për vendimarrje duke konsideruar dhe nevojat për tarifatat dhe buxhetin.
(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)



81. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).
82. Reflektime mbi draftin përfundimtar të buxhetit të marra nga konsultimet publike.
*(Kryetari i Këshillit, Sekr. i këshillit,
Anëtarët e Komisionit të ekonomisë).*
83. Pjesëmarrje në konferencat e organizuara nga Min e Financave dhe Projektet e ndryshme për buxhetimin dhe sistemin e tarifave.
(Anëtarët e Komisionit të Ekonomisë)
84. Ceremoni për dhënie titujsh nderi për vendimet e dhëna më herët nga Këshilli i Bashkisë, kryesisht me rastin e festive të nëntorit.
(Kryetari i Këshillit dhe Sek. i Këshillit)
85. Organizimi i Festës së shpalljes së pavarësisë dhe çlirimit të vëndit.
(Kryetari i Këshillit dhe Sek. i Këshillit)
86. Pritja e delegacioneve nga Këshillat e Bashkive të tjera.
(Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit)
87. Miratimi i buxhetit të këshillit të Bashkisë së bashku me Buxhetin e Bashkisë.
*(Kryetari i këshillit, Sek. i Këshillit
dhe komisioni i ekonomisë)*
88. Hartimi i dokumentit të Politikës për Këshillin e Bashkisë mbi fushat prioritare ku do të fokusohet puna për vitin 2022 në mbështetje dhe të planit të veprimit për vitin 2022.
(Kryetari i këshillit, Kryesia e Këshillit dhe Sek. i Këshillit)
89. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
*(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec
në Këshillin e Qarkut Korçë)*
90. Raportime nga administrata e Bashkisë mbi Sherbimet administrative të bashkisë ndaj qytetarëve, statistika, probleme objektiva.
(Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria juridike)
91. Këshilli merr nga Kryetari i Bashkisë projekt dokumentin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm dhe të projekt-buxhetit vjetor
(Financa)



92. Këshillit informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për muajin Tetor, mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Ligji nr. 68/2017, neni 44/4).
(Financa)

93. Publikimi i draftit përfundimtar të buxhetit në faqet e rrjeteve sociale të këshillit.
(Sekretariati)

Muaji Dhjetor

94. Realizimi i 2 mbledhjeve të Këshillit sipas nevojave për vendimarrje duke konsideruar dhe nevojat e fundvitit për vendimarrje për buxhetin.
(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

95. Realizimi i 4 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

96. Realizimi im takimit vjetor me komunitetin për llogaridhënien e e Këshillit të Bashkisë. Organizimi i një publikimi on-line mbi aktivitetin e punën e Këshillit duke pritur komente dhe sygjerime nga komuniteti.
(Sekretari i Këshillit)

97. Ceremoni për dhënie tituj nderi për figura të spikatura të qytetit për vitin 2020.
(Kryetari i Këshillit dhe Sekretari i Këshillit)

98. Realizimi i një emisioni televiziv ku të pasqyrohet puna e Këshillit për vitin 2020 si dhe rezultatet e anketimeve dhe sygjerimeve të marra nga komuniteti.
(Kryesia e Këshillit)

99. Hartimi i planit vjetor 2023 të vendimarrjes së Këshillit.
(Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit)

100. Hartimi i Planit vjetor të komunikimit dhe konsultimit me publikun për vitin 2023.
(Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit).

101. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

102. Analiza e Drejtorisë të së Ardhurave për grumbullimin e taksave dhe tarifave vendore efektet në buxhet, planifikimi.
(Drejtoria e te Ardhurave)



- *Ky plan i aktiviteteve mund të ndryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.*
- *Cdo ndryshim im tij nëpërmjet vendimarrjes, apo zhvillimit të aktivitetit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan dhe do të jetë objekt i monitorimit të performacës së Këshillit dhe do raportohet si i tillë në fund të vitit.*